



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.13

25 shkurt

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 223 datë 4.2.2010	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt”.....	409
Ligj nr.10 224 datë 4.2.2010	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja nga karburanti i depozitave, 2001.....	422
Ligj nr.10 225 datë 4.2.2010	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.10, datë 23.12.2009 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr.10 025, datë 27.11.2008 “Për buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar”.....	432
Ligj nr.10 226 datë 4.2.2010	Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr.7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar.....	432
Ligj nr.10 227 datë 4.2.2010	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8366, datë 2.7.1998 “Për shërbimin gjeologjik shqiptar (SHGJSH)”, të ndryshuar.....	433
Ligj nr.10 228 datë 4.2.2010	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.....	436

LIGJ
Nr.10 223, datë 4.2.2010

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PARREGULLT”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës për ripranimin e personave me qëndrim të parregullt”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6424, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS
PËR RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PARREGULLT

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshilli i Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës (të quajtura më poshtë "Palë Kontraktuese"),

Me dëshirën për të pasur marrëdhënie miqësore midis dy shteteve;

Me dëshirën për të bashkëpunuar në ripranimin e personave që kanë hyrë ose qëndrojnë në mënyrë të parregullt;

Me dëshirën për të kontribuar në parandalimin e lëvizjes së paligjshme të personave dhe në përputhje me parimet e bashkëpunimit europian, si dhe në përputhje me interesat dypalëshe, kanë rënë dakord si vijon:

I
PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Marrëveshjeje:

a) “Ripranim” do të thotë transferimi nga pala kërkuese dhe pranimi drejt palës që i

drejtohet kërkesa të personave (shtetas të palës që i drejtohet kërkesa ose qytetarë të vendeve të treta, ose persona pa shtetësi), të cilët kanë hyrë, qëndrojnë ose banojnë në palën kërkuese, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje;

b) “Shtetas i Republikës së Shqipërisë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar;

c) “Shtetas i Bosnjës dhe Hercegovinës” do të thotë çdo person i cili mban shtetësinë e Bosnjës dhe Hercegovinës, në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar;

d) “Shtetas i vendit të tretë” do të thotë çdo person i cili mban shtetësi të ndryshme nga ajo e Shqipërisë dhe Bosnje-Hercegovinës;

e) “Person pa shtetësi” do të thotë çdo person i cili nuk zotëron një shtetësi;

f) “Leje qëndrimi” do të thotë një leje e çdo tipi e lëshuar nga Republika e Shqipërisë ose Bosnja dhe Hercegovina, që i jep të drejtë një personi të qëndrojë në territorin e saj. Kjo nuk do të përfshijë lejet e përkohshme për të qëndruar në territorin e saj në lidhje me procedurat e aplikimit për azil ose një aplikim për leje qëndrimi;

g) “Vizë” do të thotë një autorizim për të hyrë, qëndruar ose kaluar përmes territorit të saj, lëshuar nga njëra prej palëve kontraktuese, kjo nuk do të përfshijë vizën e tranzitit aeroportual;

h) “Shtet kërkuar” do të thotë shteti që dorëzon një aplikim ripranimi, pranimi ose tranzitimi;

i) “Shtet i kërkuar” do të thotë shteti të cilit i drejtohet aplikimi për ripranim, pranim ose tranziti;

j) “Autoriteti kompetent” do të thotë çdo autoritet kombëtar përgjegjës për implementimin e kësaj Marrëveshjeje;

k) “Tranzit” do të thotë kalimi i një qytetari të një vendi të tretë ose personi pa shtetësi përmes territorit të shtetit të cilit i drejtohet kërkesa, ndërsa udhëton nga shteti kërkuar drejt vendit të destinacionit.

II

RIPRANIMI I SHTETASVE TË SHTETEVE TË PALËVE KONTRAKTUESE

Neni 2

1. Secila palë kontraktuese pranon në territorin e shtetit të saj, me kërkesën e palës tjetër kontraktuese, dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të cituara në këtë Marrëveshje, personin që qëndron në mënyrë të parregullt në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese, nëse provohet ose prezumohet në mënyrë të vlefshme se personi zotëron shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

2. Secila palë kontraktuese do të pranojë gjithashtu fëmijë minorene të personave referuar në paragrafin 1 të këtij neni, pavarësisht vendlindjes së tyre dhe shtetësisë, përveç nëse kanë të drejtë të pavarur të qëndrojnë në palën kontraktuese kërkuese.

3. Pala kontraktuese kërkuese ripranon personin të referuar në paragrafin 1 dhe 2, sipas të njëjtave dispozita, nëse më vonë, në bazë të hetimeve të mëtejshme, përcaktohet se në kohën kur ai/ajo u transferua nga territori i shtetit të palës kërkuese, ai/ajo referuar paragrafit 1 të këtij neni nuk e zotëronte shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

4. Në rast të transferimit të personit referuar paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, që ka nevojë për kujdes të veçantë për arsye të moshës së tij/saj, gjendjes së keqe shëndetësore ose për ndonjë arsye tjetër të rëndësishme, çdo palë kontraktuese informon për këtë palën tjetër.

Neni 3

1. Pasi pala kontraktuese e kërkuar dërgon një përgjigje pozitive për kërkesën e ripranimit, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar, me kërkesë të palës kontraktuese kërkuese, lëshon pa vonesë dhe brenda 7 ditëve një dokument zëvendësues udhëtimi falas që është i nevojshëm për kthimin e personit që transferohet në përputhje me nenin 2, paragrafi

1 dhe 2. Edhe nëse brenda 7 ditëve kërkesa nuk është realizuar, të dyja palët mund të përdorin dokumente standarde udhëtimi për ripranimin i cili është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

2. Kur ka dyshime për vlefshmërinë e shtetësisë së prezumuar, misioni diplomatik ose autoriteti konsullor i palës kontraktuese të kërkuar interviston personin brenda shtatë (7) ditëve nga dorëzimi i aplikimit për pranimin e personit. Me miratimin e misionit diplomatik ose autoritetit konsullor, pala kontraktuese kërkuese do ta mundësojë këtë intervistë brenda një kohe sa më të shkurtër. Nëse ky shqyrtim tregon se personi zotëron shtetësinë e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar, misioni diplomatik apo autoriteti konsullor do të lëshojë menjëherë një dokument zëvendësues udhëtimi.

III

RIPRANIMI I SHTETASVE TË VENDEVE TË TRETA DHE PERSONAVE PA SHTETËSI

Neni 4

1. Nëse personi që ka hyrë në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese nuk arrin të përmbushë kushtet në fuqi për hyrje apo qëndrim, dhe nëse ky person ka një vizë të vlefshme ose një leje të vlefshme qëndrimi, të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, kjo e fundit e ripranon atë me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese dhe pa formalitete të tjera, përveç atyre të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2. Nëse të dyja palët kontraktuese lëshuan një vizë ose një leje qëndrimi, detyrimi për ta pranuar do të jetë i asaj pale kontraktuese për të cilën vlefshmëria e vizës ose lejes së qëndrimit skadon më vonë.

Neni 5

1. Pala kontraktuese e kërkuar pranon shtetas të vendeve të treta apo persona pa shtetësi me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese, nëse kjo e fundit provon apo prezumon në mënyrë të vlefshme se personi, i cili nuk i plotëson kërkesat efektive për hyrje apo qëndrim, e ka kaluar kufirin shtetëror të shtetit të palës kontraktuese kërkuese, pasi ka qëndruar ose ka kaluar përmes territorit të shtetit të palës kontraktuese të kërkuar.

2. Detyrimi për të ripranuar sipas paragrafit 1, nuk zbatohet ndaj një personi, i cili në kohën e hyrjes në territorin e shtetit të palës kontraktuese kërkuese kishte një leje qëndrimi të vlefshme të lëshuar nga ajo palë kontraktuese, ose të cilit i ishte dhënë lejeqëndrimi nga ajo palë kontraktuese pas hyrjes së tij/saj, përveç:

- Nëse ai person kishte një vizë ose lejeqëndrimi me periudhë më të gjatë vlefshmërie, të lëshuar nga pala kontraktuese e kërkuar, ose

- Nëse viza ose leja e qëndrimit ishte lëshuar në shtetin e palës kontraktuese kërkuese, në bazë të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara ose deklaratave të rreme.

3. Pala kontraktuese kërkuese ripranon një shtetas të një shteti të tretë ose një person pa shtetësi, nën të njëjtat kushte, nëse më pas përcaktohet se në kohën e transferimit të tij/saj nga territori i shtetit të palës kontraktuese kërkuese nuk plotësoheshin kushtet e nenit 4, paragrafi 1 dhe nenit 5 paragrafi 1.

Neni 6

Detyrimi për të ripranuar, në përputhje me nenet 4 dhe 5, nuk zbatohet për një shtetas nga vendet e treta ose për një person pa shtetësi:

- a) të cilit i është dhënë statusi i refugjatit nga pala kontraktuese kërkuese, në bazë të Konventës për Statusin e Refugjatëve (Gjenevë, 28 korrik 1951) dhe Protokollit për Statusin e Refugjatëve (Nju Jork, 31 janar 1967);

- b) i cili është në procedurë të njohjes nga pala kontraktuese kërkuese lidhur me mbrojtjen ndërkombëtare deri në vendimmarrjen ekzekutive;

c) i cili është transferuar paraprakisht nga pala kontraktuese e kërkuar për në shtetin e origjinës ose ndonjë shtet tjetër, dhe i cili më pas hyri në territorin e palës kontraktuese kërkuese nga territori i shtetit të tretë.

IV PROCEDURAT

Neni 7

1. Procedura e ripranimit fillohen nga pala kontraktuese duke dorëzuar një kërkesë për ripranim për shtetas të palës kontraktuese ose kërkesë për ripranim të shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi.

2. Nuk do të nevojitet aplikim ripranimi kur personi që do të ripranohet zotëron një dokument të rregullt udhëtimi ose kur është e mundur një vizë e vlefshme ose lejeqëndrimi për në palën kontraktuese të kërkuar.

3. Pala kontraktuese e kërkuar, referuar në paragrafin 1 të këtij neni, do t'i përgjigjet palës kontraktuese kërkuese.

4. Do të jepen arsyet për refuzimin e një kërkesë ripranimi.

5. Pala kontraktuese që transferon një person, do të lajmërojë kohën e transferimit të tij/saj, pikën e kalimit kufitar dhe shoqëruesit e mundshëm dhe pala kontraktuese e kërkuar do ta konfirmojë ripranimin e tij/saj.

6. Dorëzimi i një kërkesë për ripranim dhe përgjigja e saj, si dhe njoftimi i pranimit ose jo të tij, do t'u dërgohet direkt autoriteteve kompetente në formë elektronike, faks ose me postë të rregullt.

7. Transporti mund të bëhet në rrugë ajrore ose tokësore.

V AFATET KOHORE

Neni 8

1. Aplikimi për ripranim duhet t'i dorëzohet autoritetit kompetent të palës kontraktuese të kërkuar, maksimumi 180 ditë, pasi autoriteti kompetent i palës kontraktuese kërkuese është vënë në dijeni se një shtetas i një prej palëve kontraktuese ose i një vendi të tretë, ose një person pa shtetësi nuk plotëson, ose nuk plotëson më, kushtet në fuqi për të hyrë, qëndruar ose banuar në të. Kur ka pengesa ligjore ose faktike për dorëzimin e aplikimit në kohë, afati kohor do të zgjatet me kërkesën e palës kontraktuese kërkuese derisa pengesat të kenë pushuar së ekzistuari.

2. Një aplikim ripranimi kërkon përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve kalendarike në të gjitha rastet. Kjo kohë fillon që nga data e marrjes së kërkesës së ripranimit. Nëse nuk do të ketë përgjigje brenda këtij afati, transferimi do të quhet si i pranuar.

3. Kur ka pengesa ligjore ose faktike për t'iu përgjigjur aplikimit brenda 10 ditëve kalendarike, ky afat kohor do të zgjatet, sipas kërkesës së motivuar në një maksimum prej 6 ditësh kalendarike. Nëse nuk do të ketë përgjigje brenda këtij afati të zgjatur kohor, transferimi do të quhet i pranuar.

4. Pala kontraktuese kërkuese do të njoftojë për transferimin e një personi 72 orë para transferimit të tij/saj dhe pala kontraktuese e kërkuar do të konfirmojë ripranimin në kohën më të shkurtër të mundur, por jo më vonë se 48 orë pas marrjes së njoftimit të transferimit. Nëse nuk do të ketë përgjigje mbi konfirmimin e pranimit brenda këtij afati kohor, transferimi do të quhet i pranuar.

VI TRANZITI

Neni 9

1. Secila palë kontraktuese lejon tranzitin e një shtetasi të një pale të tretë ose një personi pa shtetësi, përmes territorit të shtetit të saj, në qoftë se kjo kërkohet me shkrim nga pala tjetër kontraktuese, pasi pala kontraktuese që dorëzon një aplikim tranziti ka siguruar pranimin në shtetin e destinacionit dhe tranzitit përmes shteteve të tjera. Në këto raste pala kontraktuese që pranon kërkesën e tranzitit përmes territorit të saj nuk duhet të kërkojë vizë tranziti për qytetarë të vendeve të treta ose persona pa shtetësi për të cilët tranziti është aprovuar.

2. Pala kontraktuese kërkuese do t'i garantojë palës kontraktuese të kërkuar se personi, tranziti i të cilit lejohet, ka një biletë udhëtimi dhe një dokument të vlefshëm udhëtimi për në shtetin e destinacionit.

3. Pala kontraktuese që merr aplikimin për tranzit, brenda 5 ditëve kalendarike do të informojë me shkrim palën kontraktuese që kërkon tranzitin, duke konfirmuar datën dhe pikën kufitare hyrëse për në vend, ose të informojë për refuzimin e tranzitit dhe për arsyet e refuzimit.

4. Në rast të tranzitit në rrugë ajrore me shoqërimin e një eskorte policore, pala kontraktuese kërkuese siguron këtë shoqërim deri në aeroportin e palës kontraktuese të kërkuar, me kusht që eskorta policore të mos largohet përtej zonës ndërkombëtare të aeroportit. Nëse tranziti me eskortë policore vazhdon përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, ajo palë kontraktuese siguron eskortën policore.

5. Pala kontraktuese kërkuese ka përgjegjësinë për pranimin e personit për në vendin e destinacionit dhe vendet e tranzitit dhe personi do të ripranohet nëse ripranimi i tij/saj refuzohet në shtetin e destinacionit ose shtetet e tjera të tranzitit.

Neni 10

1. Tranziti mund të refuzohet nëse një shtetas i një vendi të tretë ose person pa shtetësi është në rrezik:

a) të jetë subjekt torture ose trajtimi çnjerëzor, degradues ose ndëshkim, ose dënimi me vdekje ose persekutim në shtetin e destinacionit për arsye race, feje, kombësie, anëtarësie në një grup shoqëror të caktuar ose për arsye të opinioneve të tij/saj politike në shtetin e destinacionit ose një shteti tjetër tranziti, ose

b) të ndjekjes penale në shtetin e destinacionit ose ekzekutimin e një dënimi të dhënë për një veprë penale të kryer para se të ndodhte tranziti, ose

c) të ndjekjes penale në shtetin e destinacionit ose ekzekutimin e një dënimi të dhënë për një veprë penale të kryer para se të ndodhte tranziti, me përjashtim të rasteve të kalimit të paligjshëm të kufijve shtetërorë.

2. Tranziti i shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi mund të refuzohet mbi bazën e deportimit dhe hyrjes së ndaluar në fuqi, shëndetit publik, sigurisë së brendshme, rendit publik dhe interesave kombëtarë të shtetit të kërkuar.

3. Një person që pranohet për tranzit mund t'i kthehet palës kontraktuese kërkuese, nëse faktet e përmendura në paragrafin 1 dhe 2 vërtetohen më pas.

VII RIMBURSIMI I SHPENZIMEVE

Neni 11

1. Shpenzimet e lidhura me ripranimin e personave deri në kufi, në zbatim të nenit 2, paragrafi 1 dhe 2, nenit 4 paragrafi 1 dhe nenit 5, paragrafi 1 të palës kontraktuese të kërkuar mbulohen nga pala kontraktuese kërkuese. Shpenzimet, në lidhje me kthimin e mundshëm të personave për t'u ripranuar, mbulohen gjithashtu nga pala kontraktuese kërkuese.

2. Shpenzimet e kalimit tranzit të një shtetasi të një pale të tretë deri në kufirin e shtetit të destinacionit, duke përfshirë edhe shpenzimet që lidhen me tranzitin përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, sikurse edhe shpenzimet që lidhen me një kthim të mundshëm të tij/saj mbulohen nga pala kontraktuese kërkuese.

VIII MBROJTJA E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 12

1. Të dhënat personale të komunikuar, të cilat janë të nevojshme për të realizuar zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, mbrohen në përputhje me rregullat ligjore kombëtare të shteteve të palëve kontraktuese.

2. Nëse zbatimi i kësaj Marrëveshjeje kërkon shkëmbim të dhënash personale të personit, ndërmjet palëve kontraktuese, këto të dhëna mund të jenë vetëm në lidhje me:

a) të dhënat personale të personit që duhet të transferohet ose të ripranohet, të të afërmeve të tij/saj (p.sh. emri, mbiemri, emra të mëparshëm, pseudonime, emra të rremë, data dhe vendi i lindjes, gjinia, shtetësia aktuale dhe të mëparshmet);

b) pasaportën, kartën e identitetit, dokumente të tjera identiteti, ose dokumente udhëtimi dhe lejejalimi (numri, data e skadimit, data e lëshimit, organi lëshues, vendi i lëshimit);

c) të dhëna të tjera të nevojshme për të identifikuar personin që do të transferohet apo do të pranohet (p.sh. foto, shenja gishtërinjsh);

d) vendin e qëndrimit dhe rrugën (itinerari);

e) lejeqëndrimin apo vizën.

3. Të dhënat personale duhet të merren për qëllimin e specifikuar, të qartë dhe ligjor të implementimit të kësaj Marrëveshjeje dhe nuk do të përdoren më nga autoritetet komunikuese ose marrëse në një mënyrë që nuk ka të bëjë me këtë qëllim.

4. Të dhënat personale mund t'u komunikohen vetëm autoriteteve kompetente për implementimin e kësaj Marrëveshjeje, të cilët do të jenë të vetmit që do t'i përdorin në mënyrë që t'u ndalohet hyrja personave të paautorizuar. Komunikime të mëtejshme për organe të tjera kërkojnë miratimin paraprak të autoritetit komunikues.

5. Pala kontaktuese që komunikon të dhënat garanton se ato janë të sakta, të nevojshme dhe në përputhje me qëllimin e komunikimit. Nëse të dhënat nuk janë të sakta ose janë komunikuar në mënyrë të paligjshme, pala kontraktuese marrëse duhet të informohet menjëherë në mënyrë që t'i shkatërrojë ato.

6. Me kërkesë personale çdo person informohet për komunikimin e të dhënave që kanë të bëjnë me të duke përfshirë qëllimin e tyre.

7. Të dhënat personale të komunikuar do të mbahen për periudhën kohore aq gjatë sa është e nevojshme, në përputhje me qëllimin e komunikimit.

8. Komunikimi dhe autoritetet marrëse janë nën detyrimin për të mbajtur kopje të komunikimit dhe marrjes së të dhënave personale.

IX DISPOZITA TË PËRGJITHSHME DHE PËRFUNDIMTARE

Neni 13

1. Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Sigurisë e Bosnjës dhe Hercegovinës do të përfundojnë një protokoll zbatimi në të cilin ata specifikojnë:

a) dokumentet që provojnë apo prezumojnë në mënyrë të vlefshme shtetësinë e palëve kontraktuese;

b) përgatitjen e kërkesave për ripranimin dhe tranzitin, mënyrën e paraqitjes dhe shqyrtimit të tyre;

- c) mjete për të provuar apo për të prezumuar në mënyrë të vlefshme hyrjen apo qëndrimin në territorin e shtetit të palës kontraktuese;
- d) autoritetet kompetente të autorizuar për ta zbatuar këtë Marrëveshje;
- e) pikat e kalimit kufitar të përdorura për zbatimin e Marrëveshjes.

Neni 14

1. Autoritetet kompetente të palëve kontraktuese të autorizuar për ta zbatuar këtë Marrëveshje bashkëpunojnë dhe konsultohen drejtpërsëdrejti.
2. Në rast vështirësish, në lidhje me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, kërkesa për konsultim duhet të paraqitet përmes kanaleve diplomatike.
3. Secila palë kontraktuese cakton të paktën dy ekspertë për të vlerësuar zbatimin e marrëveshjes dhe nëse është e nevojshme paraqet propozime për zgjidhjen e çështjeve që lidhen me zbatimin e saj. Në të tilla shqyrtime mund të ftohen edhe ekspertë të tjerë.

Neni 15

1. Dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk përmbajnë paragjykitime për të drejtat dhe detyrimet e palëve kontraktuese që lindin nga ligjet ndërkombëtare dhe veçanërisht, nga
 - Konventa e 28 korrikut 1951 mbi statusin e refugjatëve, të amenduar me protokollin e 31 janarit 1967 mbi statusin e refugjatëve;
 - Konventës europiane të 4 nëntorit 1950 për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
 - Konventën e 10 dhjetorit 1984 kundër torturës dhe trajtimit mizor, çnjerëzor ose degradues ose ndëshkimit;
 - Konventa ndërkombëtare mbi ekstradimin dhe tranzitin;
 - Marrëveshje të tjera ndërkombëtare mbi ripranimin e shtetasve të huaj.

Neni 16

1. Kjo Marrëveshje firmoset për një periudhë kohe të pacaktuar. Marrëveshja hyn në fuqi ditën e parë të muajit që ndjek shkëmbimin e njoftimit nëpërmjet të cilit palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën për përmbushjen e procedurave kombëtare të nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.
2. Marrëveshja do të zbatohet provizorisht që nga data e nënshkrimit.
3. Secila palë kontraktuese mund ta pezullojë zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, tërësisht apo pjesërisht, me përjashtim të nenit 2, për arsye të mbrojtjes së sigurisë kombëtare, rendit publik dhe shëndetit publik. Palët kontraktuese do të njoftojnë njëra-tjetrën pa vonesë për marrjen e kësaj mase apo për anulimin e saj nëpërmjet kanaleve diplomatike. Pezullimi i zbatimit të Marrëveshjes do të hyjë në fuqi me dorëzimin e njoftimit palës tjetër kontraktuese.
4. Secila palë kontraktuese mund ta denoncojë me shkrim Marrëveshjen nëpërmjet kanaleve diplomatike. Marrëveshja skadon në ditën e nëntëdhjetë (90-të) pas dorëzimit të njoftimit të përfundimit.
Bërë më _____ në _____ në dy origjinale, secila prej të cilave në gjuhën shqipe, në gjuhët zyrtare të Bosnjës dhe Hercegovinës (boshnjake, kroate dhe serbe) dhe në gjuhën angleze, të gjitha tekstet autentike dhe të vlefshme ligjërishit. Në rast keqinterpretimi, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

PROTOKOLL
NË ZBATIM TË MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË BOSNJËS DHE HERCEGOVINËS
MBI RIPRANIMIN E PERSONAVE ME QËNDRIM TË PARREGULLT

Ministria e Brendshme e Republikës së Shqipërisë dhe Ministria e Sigurisë së Bosnjës dhe Hercegovinës (më poshtë referohen si “Palët Kontraktuese”),

në vijim të nenit 13 të Marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave të Bosnjës dhe Hercegovinës, mbi ripranimin e personave me qëndrim të parregullt, përfunduar në-----më ----- (më poshtë referuar “Marrëveshje”), me qëllim për të bërë efektive dhe lehtësuar zbatimin e Marrëveshjes,

ranë dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Vendosja dhe vlefshmëria e shtetësisë

1. Sipas kësaj Marrëveshjeje shtetësia e një personi vendoset në bazë të dokumenteve të vlefshme të mëposhtme:

Për shtetësinë shqiptare me anë të:

- a) kartës së identitetit;
- b) certifikatës së lindjes me fotografi/lejekalimi;
- c) pasaportë e çdo lloji;
- d) librezë e shërbimit ushtarak;
- e) patentë për drejtimin e automjetit.

Për shtetësinë e Bosnje-Hercegovinës me anë të:

- a) Pasaportës (diplomatike, shërbimi, personale dhe pasaporta kolektive);
- b) Karta e identitetit (lëshuar nga projekti CIPS);
- c) Certifikata e shtetësisë me dokumente zyrtare të tjera të vlefshme me fotografi.

1. Shtetësia provohet pa nevojën e hetimit të mëtejshëm, kur paraqiten prova të vlefshme që referohen në paragrafin 1 të këtij neni.

2. Shtetësia e personit që do të transferohet, në përputhje me nenin 2 të Marrëveshjes, bëhet e vlefshme me anë të dokumenteve të mëposhtme:

- a) Një dokument me afat të mbaruar referuar në paragrafin 1 të këtij protokoll;
- b) Librezë e shërbimit ushtarak ose një tjetër dokument identiteti, lëshuar nga anëtarët e forcave të armatosura;
- c) Librezë e marinarit;
- d) Certifikata e lindjes, martesës;
- e) Patentë për drejtim automjeti;
- f) Çdo dokument i lëshuar nga autoritetet kompetente;
- g) Një fotokopje të dokumenteve të lartpërmendura, si dhe dokumentet me afat të përfunduar;
- h) Një deklaratë zyrtare nga personi ose një dëshmitar.

3. Shtetësia do të konsiderohet e vlefshme nga palët kontraktuese, vetëm nëse caktohet ndryshe nga palët kontraktuese të kërkuara.

4. Nëse palët kontraktuese të kërkuara e ripranojnë personin, për shkak se më pas vendoset se ai/ajo nuk ka zotëruar kombësinë e shtetit të palëve kontraktuese të kërkuara, duhet t’u kthejë palëve kontraktuese kërkuese të gjitha dokumentet që zotëron të personit të ripranuar.

Neni 2

Aplikimi për ripranimin e qytetarit të shtetit të palëve kontraktuese dhe kërkesat për paraqitjen e tyre

1. Aplikimet e paraqitura për ripranimin e qytetarit të palëve kontraktuese në vijim të nenit 2 të Marrëveshjes duhet të përmbajnë, në veçanti, informacionin e mëposhtëm:

- a) Të dhënat e identitetit të personit që do të ripranohet;
- b) Veçantitë me dokumentet e referuara në nenin 1 të këtij protokoll, që lejojnë vërtetimin ose vlefshmërinë e qytetarisë së personit që do të ripranohet;
- c) Të dhëna mbi fëmijë minorenë që do të rikthehen me prindërit;
- d) Një foto e personit që do të ripranohet;
- e) Informacion mbi nevojën për sigurimin e personit që do të ripranohet me kujdes shëndetësor të veçantë ose lloj tjetër kujdesi.

2. Aplikimi për ripranim do të dërgohet menjëherë për autoritetet e specifikuar në nenin 7 të këtij protokoll, veçanërisht me anë të: e-mail, fax ose postë normale.

3. Transferimi i personit që do të ripranohet do të bëhet vetëm me marrjen e miratimit të palës shtetërore të kërkuar për praninë, ose pas afatit të mbaruar të përcaktuar nga kjo Marrëveshje.

Neni 3

Aplikimi për ripranimin e shtetasve nga vendet e treta dhe shtetasve pa shtetësi dhe kushtet për paraqitjen e tij

1. Aplikimi i paraqitur për ripranimin e shtetasve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi në vijim të dispozitave të nenit 4 dhe 5 të Marrëveshjes, duhet të përmbajë, në veçanti, informacionin e mëposhtëm:

- a) Të dhënat mbi identitetin e personit që do të ripranohet, dhe aty ku është e nevojshme të dhënat mbi fëmijët minorenë që kthehen së bashku me prindërit;
- b) Veçantitë në lidhje me dokumentet e referuara në nenin 3 dhe 4 të këtij protokoll që lejojnë vërtetimin dhe vlefshmërinë e hyrjes ose qëndrimit, ose tranzitit të personit që do të ripranohet në territorin e shtetit të palëve kontraktuese të kërkuara;
- c) Fotografii e personit që do të pranohet;
- d) Informacion mbi nevojën për sigurimin e personit që do të ripranohet me kujdes shëndetësor të veçantë ose lloj tjetër kujdesi.

2. Aplikimi për ripranim do të dërgohet menjëherë për autoritetet e specifikuar në nenin 7 të këtij protokoll, veçanërisht me anë të: e-mail, fax ose postë normale.

3. Pala kontraktuese e kërkuar duhet t'i dorëzojë palës kontraktuese kërkuese miratim me shkrim për ripranimin e personit.

4. Transferimi i personit që do të ripranohet do të bëhet vetëm kur të ketë mbaruar afati i përcaktuar në marrëveshje.

Neni 4

Vendosja dhe vlefshmëria e qëndrimit ose tranzitit përmes territorit të palëve kontraktuese

1. Hyrja e një shtetasi të vendeve të treta ose një personi pa shtetësi, qëndrimi i tij/saj aty ose tranziti përmes territorit të palëve kontraktuese të kërkuara, në vijim të nenit 4 dhe 5 të Marrëveshjes mund të vendoset në bazë të dokumenteve të mëposhtme:

- a) Vula e hyrjes ose daljes ose të dhëna të tjera të regjistruara nga autoritetet e palëve kontraktuese të kërkuara në dokumentet e udhëtimit ose dokumentet e tjera identifikuese;
- b) Vula e daljes së autoritetit të palës kontraktuese të kërkuar në dokumentin e udhëtimit të falsifikuar;
- c) Lejeqëndrimi e vlefshme nga pala kontraktuese e kërkuar;
- d) Vizë e vlefshme lëshuar nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar;

e) Dokumentet e identifikimit lëshuar nga autoriteti kompetent i palës kontraktuese të kërkuar;

f) Dokumente të vlefshme të azilkërkesve ose dokument refugjati, ose dokument i vlefshëm udhëtimi si refugjat, ose fotokopje e këtyre dokumenteve;

g) Bileta udhëtimi të përdorura me emrin e përmendur, që sigurojnë hyrjen e personit në territorin e palës kontraktuese të kërkuar.

2. Dokumentet e përmendura në paragrafin 1 të këtij neni, shërbejnë si provë indirekte qëndrimi ose tranziti përmes territorit të shteteve të palëve kontraktuese.

3. Hyrja e shtetasve nga vendet e treta ose personave pa shtetësi, qëndrimi i tij/saj aty ose tranziti përmes territorit të palës kontraktuese të kërkuar, në vijim të nenit 4 dhe 5 të Marrëveshjes mund të jetë i vlefshëm në bazë të fakteve të mëposhtme:

a) lejet e qëndrimit të lëshuara nga autoriteti i palës kontraktuese të kërkuar dhe vlefshmëria e të cilave ka përfunduar ose fotokopje;

b) viza e përfunduar ose fotokopja e saj;

c) dokumentet e refugjatit, vlefshmëria e të cilave ka përfunduar (dokument i azilkërkimit, dokumentet e refugjatit ose dokumentet e udhëtimit të refugjatit) ose fotokopjet;

d) dokumentet zyrtare të autoriteteve kompetente të palës kontraktuese të kërkuar, që i është lëshuar personit gjatë kohës së qëndrimit të tij/saj ose tranzitit përmes territorit të shtetit ose fotokopje të tyre;

e) biletat e udhëtimit;

f) fatura e përcaktuar e hotelit të personit;

g) certifikata e shkëmbimit të valutës;

h) deklaratat të bëra me shkrim dore nga personi ose i regjistruar zyrtarisht nga autoritetet kompetente të palës kontraktuese kërkuese;

i) vendimet, protokollet dhe minutat e autoriteteve të vendeve të treta;

j) deklaratat nga dëshmitarët e regjistruar nga autoritetet kontraktuese;

k) informacioni që mund të kontrollohet që vërteton se personi në territorin e shtetit të palës kontraktuese të kërkuar ka përdorur shërbimet e agjencisë së udhëtimit ose transferimi ilegal individual i personave nga kufiri shtetëror.

4. Provat nga paragrafi 3 i këtij neni shërbejnë si supozim i qëndrimit ose tranzitit nga territori i shtetit të palës kontraktuese. Ky supozim mund të anulohet nga fakte të kundërta të siguruara nga autoritetet kompetente të palës kontraktuese të kërkuar që mund të nënshtrojnë kontrollë shtesë.

Neni 5

Aplikimi për tranzitin e qytetarëve të vendeve të treta ose personave pa shtetësi

1. Aplikimi i paraqitur për tranzit, në përputhje me nenin 9 të Marrëveshjes, duhet të përmbajë në veçanti informacionin e mëposhtëm:

a) Të dhëna në lidhje me identitetin dhe shtetësinë e personave që do të jenë tranzit;

b) Përlligje e paraqitjes së aplikimit;

c) Të dhëna në lidhje me dokumente të vlefshme udhëtimi që zotëron personi në tranzit;

d) Të dhëna në lidhje me udhëtimin, mjetet e transportit, koha dhe vendi i mbërritjes në shtetin e palës kontraktuese të kërkuar, shteti dhe vendi i destinacionit;

e) Të dhëna në lidhje me anëtarët e eskortës policore (identiteti, dokumenti i udhëtimit që disponojnë);

f) Të dhënat mbi biletat e udhëtimit.

2. Aplikimi për transferim duhet t'u paraqitet autoriteteve të specifikuar në nenin 7 të këtij protokollit të paktën shtatëdhjetë e dy (72) orë përpara tranzitit me anë të e-mailit ose fax-it.

3. Autoritetet kompetente të palës kontraktuese duhet të informojnë direkt mbi kohën dhe mënyrën e tranzitit (p.sh. numri i udhëtimit, koha e mbërritjes dhe nisjes, emri dhe mbiemri i zyrtarëve shoqërues, targarat e automjetit të regjistruar etj.).

4. Pala kontraktuese e kërkuar duhet të përgjigjet me shkrim ndaj aplikimit brenda një kohe sa më të shkurtër, gjithsesi, jo më vonë se dyzet e tetë (48) orë nga marrja e aplikimit. Nëse nuk

merret një përgjigje për konfirmimin e pranimit brenda këtij afati kohor, transferimi do të konsiderohet i aprovuar.

Neni 6

Pikat e kalimit

Për zbatimin e marrëveshjes duhet të përdoren pikat e mëposhtme të kalimit të kufirit:

Në Republikën e Shqipërisë:

a) Pika e kalimit të kufirit Hani i Hotit

e-mail: hanihotit@mrp.gov.al

b) Pika e kalimit të kufirit Muriqan

e-mail: muriqan@mrp.gov.al

c) Komisariati i Policisë Kufitare “Aeroporti Ndërkombëtar-Rinas”

Tel/Fax: 00355 42 36 40 28

e-mail: rinas@mrp.gov.al

Në Bosnjë dhe Hercegovinë:

a) Pika e kalimit të kufirit “Aeroporti Ndërkombëtar-Sarajevë”

00 387 33 755 359

e-mail: sara_dgs@bih.net.ba

b) Pika e kalimit të kufirit “Zupci-Herceg Novi”

00 387 59 480 790

c) Pika e kalimit të kufirit “Klobuk-Trebinje”

00 387 59 480 789

Neni 7

Autoritetet kompetente

Autoritetet kompetente për zbatimin e Marrëveshjes janë si më poshtë vijon:

Për Republikën e Shqipërisë:

Ministria e Brendshme

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit

Departamenti i Kufirit dhe Migracionit

Adresa: bulevardi “Bajram Curri”, Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: 00355 4 22 69 32;

Tel: 00355 4 279 251/00355 4 279 253

Fax: 00355 4 279 263

e-mail: policiakufitare.migracioni@mrp.gov.al

Për Bosnje dhe Hercegovinën:

Për ripranimin e personave nga Bosnja dhe Hercegovina:

Ministria e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë

Trg Bosne i Hercegovine broj 1.

71 000 Sarajevo

Tel: 00387 33 492 476

Fax: 00387 33 492 794

e-mail: readmisija@msb.gov.ba

Për ripranimin e personave nga vendet e treta dhe personave pa shtetësi:

Ministria e Sigurisë në Bosnje dhe Hercegovinë

Shërbimi për Marrëdhëniet me Jashtë

Pijacna 6, 71000 Sarajevo, Bosnja dhe Hercegovina

Tel: +387 33 772 963

Fax: +387 33 772 966

e-mail: ivo.ramljak@sps.gov.ba

Neni 8
Gjuha e përdorur

Gjatë zbatimit të protokollit palët e kontraktuara duhet të komunikojnë në gjuhën angleze.

Neni 9
(Anekset)

Me qëllim zbatimin e marrëveshjes dhe protokollit duhet të përdoren anekset e mëposhtme:

Aneksi 1. Kërkesë për riparim ose tranzit të personit/personave.

Aneksi 2. Dokumentet standarde të udhëtimit për të riparuarit.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

1. Ky protokoll duhet të hyjë në fuqi në të njëjtën kohë me marrëveshjen.
2. Protokollin nuk duhet të zbatohet gjatë periudhës së pezullimit të marrëveshjes.
3. Protokollin duhet të skadojë njëkohësisht me marrëveshjen.
4. Ky protokoll duhet të amendohet me shkrim me pëlqimin e të dyja palëve kontraktuese.

Bërë në Sarajevë, më 24.3.2009, në dy dokumente origjinale, respektivisht në gjuhën shqipe, në gjuhën zyrtare të Bosnje dhe Hercegovinës (boshnjake, kroate dhe serbe) dhe në gjuhën angleze, secili nga këto tekste duhet të jetë i njëjtë dhe ligjërish i vlefshëm. Në rast interpretimesh kontradiktore, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

ANEKSI 1

Autoriteti kërkues

Autoriteti kërkues

Lënda : Kërkesa për riparim ose tranzit për një person ose persona
(plotëso si e zbatueshme)

1. Emri, mbiemri, gjinia, data dhe vendi i lindjes, kombësia

2. Adresa në vendin e origjinës

3. Dokumenti i udhëtimit (tipi dhe numri, vendi dhe data e lëshimit dhe skadimit)

4. Gjuhët me të cilat kupton dhe flet personi

5. Mënyrat e transportit dhe itinerari (ajër, tokë ose det)

6. Pikat e kalimit të kufirit, data dhe koha

7. Gjendja shëndetësore

8. Rikthim i shoqëruar me eskortë (nëse ka, data dhe zyrtarët që e shoqërojnë)

9. Masat e sigurisë që janë ndërmarrë në vendin e të rikthyerit/transit (nëse kërkohen)

10. Të dhënat e rrethanave lidhur me qëndrimin ilegal/hyrja në territorin e palës së kontraktuar.

Firma dhe vula e autoritetit kërkues

ANEKSI 2

Emri i shtetit

Dokumenti i udhëtimit
Për ripranimin e -----
(fletorja zyrtare C274 19/09/1996 P 0018-0019)

Nr.prot.

I vlefshëm për një udhëtim nga:

Vendi i nisjes:

Destinacioni:

Emri:

Emri i dhënë:

Data e lindjes:

Gjatësia:

Shenja të veçanta:

Foto dhe vula

Kombësia:

Adresa në vendin e lindjes (nëse e di);

Autoriteti i lëshimit të dokumentit;

Lëshuar në datën;

Lëshuar në vendin;

Firma

Autoriteti

Shënime:-----

LIG J
Nr.10 224, datë 4.2.2010

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
PËR PËRGJEGJËSINË CIVILE PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA NDOTJA NGA
KARBURANTI I DEPOZITAVE, 2001**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në Konventën Ndërkombëtare për përgjegjësinë civile për dëmet e shkaktuara nga ndotja nga karburanti i depozitave, 2001, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij ligji.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6425, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KONVENTA NDËRKOMBËTARE MBI PËRGJEGJËSINË CIVILE PËR DËMET NGA NDOTJA
E SHKAKTUAR NGA KARBURANTI I DEPOZITAVE, 2001

(Londër, 23 mars 2001)

(Ende jo në fuqi)

ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE DETARE

IMO

KONFERENCA NDËRKOMBËTARE E VITIT 2001 MBI PËRGJEGJËSINË DHE
DËMSPËRBLIMET PËR DËMET E SHKAKTUARA NGA KARBURANTI I DEPOZITAVE
LEG/CONF. 12/19

27 mars 2001

Origjinali në:
ENGLISH

Pika 8 e programit

MIRATIMI I AKTIT PËRFUNDIMTAR DHE ÇDO INSTRUMENTI, REKOMANDIMI DHE
REZOLUTE QË RRJEDH NGA PUNIMET E KONFERENCËS

KONVENTA NDËRKOMBËTARE E VITIT 2001 MBI PËRGJEGJËSINË CIVILE PËR DËMET
NGA NDOTJA E SHKAKTUAR NGA KARBURANTI I DEPOZITAVE

Teksti i miratuar nga Konferenca

Shtetet palë në këtë Konventë,

Duke kujtuar nenin 194 të Konventës së Kombeve të Bashkuara mbi të drejtën e detit të vitit 1982, e cila parashikon që shtetet do të ndërmarrin të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar, pakësuar dhe kontrolluar ndotjen e mjedisit detar,

Duke kujtuar gjithashtu nenin 235 të asaj Konvente, i cili parashikon që, me synimin që të sigurojë dëmshpërblim të menjëhershëm e të përshtatshëm, në lidhje me të gjitha dëmet e shkaktuara nga ndotja e mjedisit detar, shtetet do të bashkëpunojnë në zhvillimin e mëtejshëm të rregullave përkatëse të së drejtës ndërkombëtare;

Duke vërejtur suksesin e Konventës Ndërkombëtare të vitit 1992 mbi përgjegjësinë civile për dëmet e ndotjes nga karburantet dhe të Konventës Ndërkombëtare të vitit 1992 mbi ngritjen e një fondi ndërkombëtar për dëmshpërblimet për dëmet e ndotjes nga karburantet, në sigurimin e asaj që dëmshpërblimi të jetë i disponueshëm për personat të cilët vuajnë dëmet e shkaktuara nga ndotja që vjen si pasojë e rrjedhjes apo shkarkimit të karburantit të mbajtur në masë në det nga anijet;

Duke vërejtur gjithashtu miratimin e Konventës Ndërkombëtare të vitit 1996 mbi përgjegjësinë dhe dëmshpërblimet, në lidhje me transportimin e lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme me anë të detit, me qëllimin që të sigurojë dëmshpërblim efektiv, të përshtatshëm dhe të menjëhershëm për dëmin e shkaktuar nga incidente në lidhje me transportimin me anë të detit të lëndëve të rrezikshme dhe të dëmshme;

Duke njohur rëndësinë e përcaktimit të përgjegjësisë së saktë për të gjitha format e ndotjes nga karburantet çka lidhet me një kufizim të përshtatshëm të nivelit të asaj përgjegjësie;

Duke pasur parasysh se masa plotësuese janë të nevojshme për të siguruar pagesën e dëmshpërblimit efektiv, të përshtatshëm dhe të menjëhershëm për dëmin e shkaktuar nga rrjedhja apo shkarkimi i karburantit të depozitave nga anijet;

Me dëshirën që të miratojnë rregulla dhe procedura ndërkombëtare uniforme për të zgjidhur çështjet e përgjegjësisë dhe për të siguruar dëmshpërblim të përshtatshëm në raste të tilla,

kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1 Përkufizime

Për qëllimet e kësaj Konvente:

1. “Anije” nënkupton çdo mjet lundruar detar dhe çdo mjet lundruar të përdorur në det, të çfarëdo lloji qoftë.
2. “Person” nënkupton çdo individ apo ortakëri ose çdo organ publik apo privat, qoftë shoqëri apo jo, duke përfshirë këtu një shtet apo cilindo nga nënndarjet e tij përbërëse.
3. “Pronar i anijes” nënkupton pronarin, duke përfshirë këtu pronarin e regjistruar, qiramarrësin e thjeshtë, drejtuesin dhe operuesin e anijes.
4. “Pronar i regjistruar” nënkupton personin apo personat e regjistruar si pronarë të anijes apo, në mungesë të regjistrimit, personin apo personat që kanë në pronësi anijen. Megjithatë, në rastin e një anijeje të zotëruar nga një shtet dhe të operuar nga një shoqëri, e cila në atë shtet është regjistruar si operuesja e anijes, “pronar i regjistruar” do të nënkuptojë këtë shoqëri.
5. “Karburant depozite” nënkupton çdo vaj mineral hidrokarbur, duke përfshirë vajin lubrifikant, të përdorur apo të synuar për t’u përdorur për operimin apo shtytjen e anijes, si edhe çfarëdo mbetjesh të këtij vaji.
6. “Konventa mbi përgjegjësinë civile” nënkupton Konventën Ndërkombëtare të vitit 1992 (e ndryshuar) mbi përgjegjësinë civile për dëmin e shkaktuar nga ndotja nga vaji.
7. “Masa parandaluese” nënkupton çfarëdo masash të arsyeshme të marra nga cilindo person pasi ka ndodhur një incident për të parandaluar apo minimizuar dëmin nga ndotja.
8. “Incident” nënkupton çdo ndodhi apo një sërë ndodhish që kanë të njëjtën prejardhje, e cila shkakton dëm nga ndotja apo krijon një kërcënim serioz dhe të menjëhershëm për të shkaktuar një dëm të tillë.
9. “Dëm nga ndotja” nënkupton:
 - a) humbjen apo dëmin e shkaktuar jashtë anijes nga ndotja që vjen si pasojë e rrjedhjes apo shkarkimit të karburantit të depozitave nga anija, kurdoherë që një rrjedhje apo shkarkim i tillë ndodh, me kusht që dëmshpërblimi për dëmtimin e mjedisit i ndryshëm nga humbja apo përfitimi nga një dëmtim i tillë, të kufizohet në kostot e masave të arsyeshme për rikthimin në pozitën e mëparshme tashmë të ndërmarra apo që do të ndërmerren; dhe
 - b) kostot e masave parandaluese dhe humbjet apo dëmet e mëtejshme të shkaktuara nga masat parandaluese.
10. “Shteti i regjistrimit të anijes” nënkupton, në lidhje me një anije të regjistruar, shtetin e regjistrimit të anijes dhe në lidhje me një anije të paregjistruar, shtetin nën flamurin e të cilit anija ka të drejtë të mbajë.
11. “Tonazh bruto” nënkupton tonazhin bruto të përlllogaritur në përputhje me rregulloret për matjen e tonazhit, siç përmbahen në shtojcën 1 të Konventës Ndërkombëtare mbi matjen e tonazhit të anijeve, 1969.
12. “Organizatë” nënkupton Organizatën Ndërkombëtare Detare.
13. “Sekretar i Përgjithshëm” nënkupton Sekretarin e Përgjithshëm të Organizatës.

Neni 2 Objekti i zbatimit

Kjo Konventë do të zbatohet vetëm për:

- a) Dëmin e ndotjes së shkaktuar:
 - i) në territorin e një shteti palë, duke përfshirë këtu detin territorial; dhe
 - ii) në zonën ekskluzive ekonomike të një shteti palë, të përcaktuar në përputhje me të drejtën ndërkombëtare ose, nëse një shtet palë nuk e ka përcaktuar një zonë të tillë, në një zonë përtej dhe afër detit territorial të atij shteti të përcaktuar nga ai shtet në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe që shtrihet jo më shumë se 200 milje detare nga vijat bazë prej të cilave matet gjerësia e detit të tij territorial.

b) Masat parandaluese, kurdoherë që ato merren, për të parandaluar apo minimizuar një dëm të tillë.

Neni 3

Përgjegjësia e pronarit të anijes

1. Përveçse siç parashikohet në paragrafët 3 dhe 4, pronari i anijes në kohën e një incidenti do të jetë përgjegjës për dëmin e ndotjes së shkaktuar nga çfarëdo karburanti depozitash në anije apo që kanë prejardhjen nga anija, me kusht që, nëse një incident konsiston në një sërë ndodhish që kanë të njëjtën prejardhje, përgjegjësia do t'i atribuohet pronarit të anijes në kohën e ndodhisë së parë nga këto ndodhi.

2. Kur më shumë se një person është përgjegjës në përputhje me paragrafin 1, përgjegjësia e tyre do të jetë e përbashkët dhe individuale.

3. Asnjë përgjegjësi nuk do t'i atribuohet pronarit të anijes për dëme të ndotjes, nëse pronari i anijes provon që:

a) dëmi ka ardhur si pasojë e një akti luftime, e veprimeve luftarake, e luftës civile, kryengritjes apo një fenomeni natyror të një natyre të jashtëzakonshme, të pashmangshme e të papërballueshme; ose

b) dëmi ishte shkaktuar tërësisht nga një veprim apo mosveprim i bërë me qëllimin për të shkaktuar dëm, nga një palë e tretë; ose

c) dëmi ishte shkaktuar tërësisht nga neglizhenca apo veprime të tjera të gabuara të cilësdo qeveri apo autoriteti tjetër përgjegjës për mirëmbajtjen e ndriçimeve apo mjeteve të tjera ndihmuese të lundrimit në ushtrim të atij funksioni.

4. Nëse pronari i anijes provon se dëmi i ndotjes ka ardhur tërësisht apo pjesërisht qoftë nga një veprim apo mosveprim i bërë me qëllimin për të shkaktuar dëm nga personi që e ka vuajtur këtë dëm apo nga neglizhenca e atij personi, pronari i anijes mund të lirohet tërësisht apo pjesërisht nga përgjegjësia përballë këtij personi.

5. Asnjë pretendim për dëmshpërblim për dëm nga ndotja nuk do të bëhet kundër pronarit të anijes në mënyrë të ndryshme nga sa është në përputhje me këtë Konventë.

6. Asgjë në këtë Konventë nuk do të çenojë çfarëdo të drejte për ankim të pronarit të anijes e cila ekziston pavarësisht nga kjo Konventë.

Neni 4

Përfshirjet

1. Kjo Konventë nuk do të zbatohet për dëmet nga ndotjet, siç përcaktohet në konventën mbi përgjegjësinë civile, pavarësisht nëse dëmshpërblimi në lidhje me të sipas asaj konvente është i pagueshëm apo jo.

2. Përveçse kur parashikohet në paragrafin 3, dispozitat e kësaj Konvente nuk do të zbatohen për anijet e luftës, anijet ndihmëse apo anije të tjera të zotëruara apo të operuara nga një shtet dhe të përdorura, për momentin, vetëm në shërbim qeveritar jotregtar.

3. Një shtet palë mund të vendosë që ta zbatojë këtë Konventë për anijet e tij të luftës apo anije të tjera të përshkruara në paragrafin 2, rast në të cilin ai do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm përkatës duke përcaktuar me hollësi afatet dhe kushtet e një zbatimi të tillë.

4. Në lidhje me anijet e zotëruara nga një shtet palë dhe të përdorura për qëllime tregtare, secili shtet do t'u nënshtrohet pretendimeve në juridiksionet e përcaktuara në paragrafin 9 dhe do të heqë të gjitha mjetet mbrojtëse të bazuara në statusin e tij si shtet sovran.

Neni 5

Incidentet që përfshijnë dy ose më shumë anije

Kur ndodh një incident që përfshin dy ose më shumë anije dhe nga kjo vjen si pasojë dëm nga ndotja, pronarët e anijeve të të gjitha anijeve në fjalë, përveçse kur lirohen nga detyrimi sipas

nenit 3, do të jenë bashkërisht dhe veçmas përgjegjës për një dëm të tillë i cili nuk është i ndashëm në mënyrë të arsyeshme.

Neni 6

Kufizimi i përgjegjësisë

Asgjë në këtë Konventë nuk do të cenohet të drejtën e pronarit të anijes dhe personit apo personave që ofrojnë sigurime apo siguri tjetër financiare për të kufizuar përgjegjësinë sipas çfarëdo regjimi të zbatueshëm kombëtar apo ndërkombëtar, të tillë si Konventa e vitit 1976 mbi kufizimin e përgjegjësisë për pretendimet detare, e ndryshuar.

Neni 7

Sigurimi i detyrueshëm apo siguria financiare

1. Pronarit të regjistruar të një anijeje që ka një tonazh bruto më shumë se 1000 të regjistruar në një shtet palë, do t'i kërkohej të ruajë sigurim apo një siguri tjetër financiare, të tilla si garancia e një banke apo një institucioni tjetër financiar të ngjashëm, për të mbuluar përgjegjësinë e pronarit të regjistruar për dëmin e ndotjes në një shumë të barabartë me kufijtë e përgjegjësive sipas regjimit të zbatueshëm kombëtar apo ndërkombëtar të kufizimit por që, në të gjitha rastet, të mos kalojë shumën e përlogaritur në përputhje me Konventën e vitit 1976 mbi kufizimin e përgjegjësive për pretendimet detare, e ndryshuar.

2. Një certifikatë që vërteton se një sigurim apo një siguri tjetër financiare është në fuqi në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente, do t'i lëshohet çdo anijeje pasi autoriteti i duhur i një shteti palë të ketë përcaktuar se është vepruar në përputhje me kërkesat e paragrafit 1. Në lidhje me një anije të regjistruar në një shtet palë, një certifikatë e tillë do të lëshohet apo do të vërtetohet nga autoriteti i duhur i shtetit të regjistrimit të anijes; lidhje me një anije jo të regjistruar në një shtet palë, ajo mund të lëshohet apo do të vërtetohet nga autoriteti i duhur i cilitdo shtet palë. Kjo certifikatë do të jetë në formën e modelit të përcaktuar në shtojcën ndaj kësaj Konvente dhe do të përmbajë hollësitë e mëposhtme:

- a) Emrin e anijes, numrin apo shkronjat dalluese dhe portin e regjistrimit;
- b) Emrin dhe vendin kryesor të punës të pronarit të regjistruar;
- c) Numrin e identifikimit të anijes sipas Organizatës Ndërkombëtare Detare;
- d) Llojin dhe kohëzgjatjen e kësaj sigurie;
- e) Emrin dhe vendin kryesor të punës së siguruesit apo personit tjetër që ofron siguri dhe atje ku është e përshtatshme, vendin e punës ku është vendosur sigurimi apo siguria;
- f) Periudhën e vlefshmërisë së certifikatës e cila do të jetë jo më e gjatë sesa periudha e vlefshmërisë së sigurimit apo sigurisë tjetër.

3.

a) Një shtet palë mund të autorizojë ose një institucion, ose një organizatë të njohur prej tij që të lëshojë certifikatën e përmendur në paragrafin 2. Një institucion apo organizatë e tillë do ta informojë atë shtet për lëshimin e secilës certifikatë. Në të gjitha rastet, shteti palë do të garantojë tërësisht plotësinë dhe saktësinë e certifikatës së lëshuar në këtë mënyrë dhe do të marrë përsipër të sigurojë rregullimet e nevojshme për ta përmbushur këtë detyrim.

b) Një shtet palë do të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm mbi:

i) përgjegjësitë dhe kushtet e veçanta të autoritetit që i është deleguar një institucioni ose organizate të njohur prej tij;

ii) tërheqjen e një autoriteti të tillë; dhe

iii) datën nga e cila ky autoritet apo tërheqja e këtij autoriteti hyn në fuqi.

Një autoritet i deleguar nuk hyn në fuqi përpara tre muajsh që nga data në të cilën njoftimi për këtë hyrje në fuqi i është dhënë Sekretarit të Përgjithshëm.

c) Institucioni apo organizata e autorizuar për të lëshuar certifikata në përputhje me këtë paragraf, së paku, do të jetë e autorizuar t'i tërheqë këto certifikata nëse nuk ruhen kushtet sipas të

cilave ato janë lëshuar. Në të gjitha rastet, institucioni apo organizata do t'i raportojë për një tërheqje të tillë shtetit, në emër të të cilit ishte lëshuar një certifikatë e tillë.

4. Certifikata do të jetë në gjuhën zyrtare të shtetit lëshues. Nëse gjuha e përdorur nuk është anglisht, frëngjisht ose spanjisht, teksti do të përfshijë një përkthim në një nga këto gjuhë dhe kur shteti vendos në mënyrë të tillë, gjuha zyrtare e shtetit mund të anashkalohet.

5. Certifikata do të mbahet në bordin e anijes dhe një kopje do të ruhet pranë autoriteteve që ruajnë të dhënat e regjistrimit të anijes ose, nëse anija nuk është e regjistruar në një shtet palë, pranë autoriteteve që lëshojnë apo vërtetojnë certifikatën.

6. Një sigurim apo siguri tjetër financiare nuk përmbush kërkesat e këtij neni, nëse ajo mund të ndërpritet, për arsye të ndryshme nga mbarimi i periudhës së vlefshmërisë së sigurimit apo sigurisë së përcaktuar në certifikatë sipas paragrafit 2 të këtij neni, përpara se të kenë kaluar tre muaj nga data në të cilën njoftimi mbi përfundimin e saj t'u jetë dhënë autoriteteve të referuara në paragrafin 5 të këtij neni, përveçse kur certifikata u është dorëzuar këtyre autoriteteve apo kur është lëshuar një certifikatë e re brenda periudhës në fjalë. Dispozitat e mëparshme do të zbatohen në mënyrë të ngjashme për çfarëdo ndryshimi që rezulton në atë që sigurimi apo siguria nuk përmbushin më kërkesat e këtij neni.

7. Shteti i regjistrimit të anijes, në përputhje me dispozitat e këtij neni, do të përcaktojë kushtet e lëshimit dhe vlefshmërisë së certifikatës.

8. Asgjë në këtë Konventë nuk do të kuptohet sikur parandalon një shtet palë nga mbështetja në informacion të përftuar nga shtetet e tjera apo nga organizata ose organizata të tjera ndërkombëtare në lidhje me pozitën financiare të ofruesve të sigurimeve apo sigurive financiare për qëllime të kësaj Konvente. Në raste të tilla, shteti palë që mbështetet në një informacion të tillë nuk lirohet nga përgjegjësia e tij si shtet që lëshon certifikatën e kërkuar nga paragrafi 2.

9. Certifikatat e lëshuara ose të vërtetuara sipas autoritetit të një shteti palë, do të pranohen nga shtetet e tjera palë për qëllimet e kësaj Konvente dhe do të quhen nga shtetet e tjera palë se kanë të njëjtën fuqi si certifikatat e lëshuara apo vërtetuara nga vetë ata edhe nëse janë lëshuar apo vërtetuar në lidhje me një anije jo të regjistruar në një shtet palë. Një shtet palë mund të kërkojë në çdo kohë këshillim me shtetin lëshues apo vërtetues nëse beson se siguruesi apo garantuesi i përmendur në certifikatën e sigurimit nuk është i aftë financiarisht që të përmbushë detyrimet e vendosura nga kjo Konventë.

10. Çfarëdo pretendimi për dëmshpërblim për dëm të shkaktuar nga ndotja mund të ngrihet drejtpërdrejt kundër siguruesit apo personit tjetër që ofron siguri financiare për përgjegjësinë e pronarit të regjistruar për dëmin e shkaktuar nga ndotja. Në një rast të tillë, i padituri mund t'u drejtohet të njëjtave mjete mbrojtëse (të ndryshme nga falimentimi apo likuidimi i pronarit të anijes) të cilave pronari i anijes do të kishte pasur të drejtë t'u drejtohej, përfshirë këtu kufizimin sipas nenit 6. Për më tepër, edhe nëse pronari i anijes nuk ka të drejtë të përfitojë nga kufizimi i përgjegjësisë sipas nenit 6, i padituri mund të kufizojë përgjegjësinë në një shumë të barabartë me shumën e sigurimit apo sigurisë tjetër financiare të kërkuar për t'u ruajtur në përputhje me paragrafin 1. Për më tepër, i padituri mund t'i drejtohet mbrojtës se dëmi nga ndotja ka ardhur si pasojë e drejtimit të keq të vetëdijshëm të pronarit të anijes, por i padituri nuk do t'i drejtohet asnjë mjeti tjetër mbrojtës të cilin i padituri mund të ketë pasur të drejtën t'i drejtohet në procedimet e ngritura nga pronari i anijes kundër të paditurit. I padituri, në çdo rast, do të ketë të drejtën t'i kërkojë pronarit të anijes që t'i bashkohet atij në procedime.

11. Një shtet palë nuk do të lejojë një anije që mban flamurin e tij, ndaj të cilës zbatohet ky nen, që të operojë në çfarëdo kohe, përveçse kur është lëshuar një certifikatë sipas paragrafëve 2 ose 14.

12. Në bazë të dispozitave të këtij neni, secili shtet palë do të sigurojë, sipas legjislacionit të tij të brendshëm, që sigurimi apo siguria tjetër, në masën e përcaktuar me hollësi në paragrafin 1, të jetë në fuqi në lidhje me cilëndo anije që ka një tonazh bruto më të madh se 1000, kudo që të jetë e regjistruar, që hyn apo që del nga një port i tij ose që mbërrin apo largohet nga një mjedis në det të hapur në detin e tij territorial.

13. Pavarësisht nga dispozitat e paragrafit 5, një shtet palë mund të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm se, për qëllime të paragrafit 12, anijeve nuk u kërkohet që të kenë në bord apo të

tregojnë certifikatën e kërkuar nga paragrafi 2, kur hyjnë apo dalin nga portet apo kur mbërrijnë ose largohen nga mjediset në det të hapur në territorin e tij, me kusht që shteti palë, i cili lëshon certifikatën e kërkuar nga paragrafi 2 të ketë njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm se ai i mban të dhënat në format elektronik, në të cilin mund të hyjnë të gjitha shtetet palë, që vërteton ekzistencën e certifikatës dhe që u mundëson shteteve palë të çlirohen nga detyrimet e tyre sipas paragrafit 12.

14. Nëse sigurimi apo siguria tjetër financiare nuk ruhet në lidhje me një anije të zotëruar nga një shtet palë, dispozitat e këtij neni në lidhje me të nuk do të jenë të zbatueshme për një anije të tillë, por anija do të mbajë një certifikatë të lëshuar nga autoriteti i përshtatshëm i shtetit të regjistrimit të anijes që deklaron se anija zotërohet nga ai shtet dhe se përgjegjësia e anijes mbulohet brenda kufijve të parashikuar në përputhje me paragrafin 1. Një certifikatë e tillë do të ndjekë sa më afër që të jetë e mundur modelin e parashikuar në paragrafin 2.

15. Një shtet, në kohën e ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit në këtë Konventë, ose në cilëndo kohë të mëvonshme, të deklarojë se ky nen nuk zbatohet për anijet që operojnë vetëm brenda zonës së atij shteti të përmendur në nenin 2 (a)(i).

Neni 8 **Afatet kohore**

Të drejtat për dëmshpërblim sipas kësaj Konvente do të shuhen përveçse kur një padi ngrihet si rrjedhim brenda tre viteve nga data kur ka ndodhur dëmi. Megjithatë, në asnjë rast nuk do të ngrihet një pretendim pas më shumë se gjashtë vjetësh nga data e incidentit që ka shkaktuar dëmin. Kur incidenti konsiston në një sërë ndodhish, periudha gjashtëvjeçare do të fillojë që nga data e së parës nga këto ndodhi.

Neni 9 **Juridiksioni**

1. Kur një incident ka shkaktuar dëm për shkak të ndotjes në territor, duke përfshirë detin territorial, ose në zonën e përmendur në nenin 2 (a)(ii), të një ose më shumë shteteve palë, apo kur janë marrë masa parandaluese për të parandaluar apo për të minimizuar dëmin nga ndotja në një territor të tillë, duke përfshirë detin territorial, ose në një zonë të tillë, pretendimet për dëmshpërblime kundër pronarit të anijes, siguruesit apo personit tjetër që ofron siguri për përgjegjësinë e pronarit të anijes, mund të ngrihen vetëm në gjykatat e cilitdo nga këto shtete palë.

2. Secilit të paditur do t'i jepet një njoftim i arsyeshëm mbi çdo pretendim të ngritur sipas paragrafit 1.

3. Secili shtet palë do të sigurojë që gjykatat e tij të kenë juridiksion për të shqyrtuar pretendime për dëmshpërblim të ngritura sipas kësaj Konvente.

Neni 10 **Njohja dhe zbatimi**

1. Çdo vendim i dhënë nga një gjykatë me juridiksion në përputhje me nenin 9 që është i zbatueshëm në shtetin e origjinës kur ai nuk u nënshtrohet më formave të zakonshme të rishikimit, do të njihet në çdo shtet palë, përveç rasteve:

- a) Kur vendimi është përfutur me anë të mashtrimit; ose
- b) Kur të paditurit nuk i është dhënë njoftim brenda një kohe të arsyeshme dhe një mundësi e drejtë për të paraqitur mbrojtjen e tij apo të saj.

2. Një vendim i njohur sipas paragrafit 1 do të jetë i zbatueshëm në secilin shtet palë sapo të plotësohen formalitetet e kërkuara në atë shtet. Formalitetet nuk do të lejojnë që çështja të rihapet në themel.

Neni 11
Dispozita e zëvendësimit

Kjo Konventë do të zëvendësojë cilëndo Konventë në fuqi apo të hapur për nënshkrim, ratifikim ose aderim në datën në të cilën kjo Konventë është e hapur për nënshkrim, por vetëm në masën që kjo Konventë do të bjerë në kundërshtim me të; megjithatë, asgjë në këtë nen nuk do të cenojë detyrimet e shteteve palë ndaj shteteve jo palë në këtë Konventë që rrjedhin sipas kësaj Konvente.

Neni 12
Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe aderimi

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim në selinë e organizatës nga data 1 tetor 2001 deri më 30 shtator 2002 dhe do të mbetet edhe më pas e hapur për aderim.
2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre që t'i nënshtrohen kësaj Konvente me anë të:
 - a) nënshkrimit pa rezerva për sa i përket ratifikimit, pranimit apo miratimit;
 - b) nënshkrimit në bazë të ratifikimit, pranimit apo miratimit, që ndiqet nga ratifikimi, pranimi apo miratimi; ose
 - c) aderimit.
3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi do të hyjë në fuqi me anë të depozitimit të një instrumenti për këtë qëllim pranë Sekretarit të Përgjithshëm.
4. Çdo instrument i ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit, i depozituar pas hyrjes në fuqi të një ndryshimi ndaj kësaj Konvente në lidhje me të gjitha shtetet palë, ose pas marrjes së të gjitha masave të kërkuara për hyrjen në fuqi të ndryshimit në lidhje me ato shtete palë, do të çmohet se zbatohet ndaj kësaj Konvente siç modifikohet nga ky ndryshim.

Neni 13
Shtetet me më shumë se një sistem të së drejtës

1. Nëse një shtet ka dy ose më shumë njësi territoriale në të cilët janë të zbatueshëm sisteme të ndryshme të së drejtës në lidhje me çështje që rregullohen në këtë Konventë, ai mundet që në kohën e nënshkrimit, ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit të deklarojë se kjo Konventë do të shtrihet në të gjitha njësitë e tij territoriale ose vetëm në një apo më shumë prej tyre dhe mund ta ndryshojë në çdo kohë këtë deklaratë duke paraqitur një deklaratë tjetër.
2. Çfarëdo deklaratë e tillë do t'i njoftohet Sekretarit të Përgjithshëm dhe do të deklarojë shprehimisht njësitë territoriale tek të cilat zbatohet kjo Konventë.
3. Në lidhje me një shtet palë i cili ka bërë një deklaratë të tillë:
 - a) në përkufizimin e “pronar i regjistruar” në nenin 1 (4), referimet tek një shtet kuptohen si referime ndaj një njësie të tillë territoriale;
 - b) referimet tek shteti i regjistrimit të një anijeje dhe në lidhje me një certifikatë të detyrueshme sigurimi, tek shteti lëshues apo vërtetues, do të interpretohen sikur referohen ndaj njësisë territoriale përkatësisht në të cilën anija është regjistruar dhe e cila lëshon apo vërteton certifikatën;
 - c) referimet në këtë Konventë ndaj kërkesave të së drejtës së brendshme do të kuptohen si referime ndaj kërkesave të së drejtës së njësisë territoriale përkatëse; dhe
 - d) referimet në nenet 9 dhe 10 te gjykatat dhe te vendimet, të cilat duhet të njihen në shtetet palë, do të interpretohen si referime përkatësisht te gjykatat dhe vendimet që duhet të njihen në njësinë territoriale përkatëse.

Neni 14
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi një vit pas datës në të cilën tetëmbëdhjetë shtete, përfshirë pesë shtete me anije tonazhi bruto i bashkuar i të cilave është jo më pak se 1 milion ton,

ose ta kenë nënshkruar atë pa rezerva në lidhje me ratifikimin, pranimin ose miratimin ose të kenë depozituar instrumente të ratifikimit, pranimit, miratimit apo aderimit pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Për cilindo shtet i cili ratifikon, pranon, miraton apo aderon në të pasi janë përmbushur kushtet e paragrafit 1 për hyrjen në fuqi, kjo Konventë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës së depozitimit nga ky shtet të instrumentit të përshtatshëm.

Neni 15 **Denoncimi**

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga secili shtet në çdo kohë pas datës në të cilën kjo Konventë hyn në fuqi për atë shtet.

2. Denoncimi do të kryhet me anë të depozitimit të një instrumenti pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

3. Një denoncim do të hyjë në fuqi një vit pas depozitimit të tij pranë Sekretarit të Përgjithshëm ose një periudhe të tillë më të gjatë, siç mund të përcaktohet me hollësi në instrumentin e denoncimit.

Neni 16 **Rishikimi ose ndryshimi**

1. Një konferencë për qëllimin e rishikimit apo ndryshimit të kësaj Konvente mund të thirret nga organizata.

2. Organizata do të thërrasë një konferencë të shteteve palë për ta rishikuar ose ndryshuar këtë Konventë me kërkesën e jo më pak se një të tretës së shteteve palë.

Neni 17 **Depozitimi**

1. Kjo Konventë do të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm.

2. Sekretari i Përgjithshëm do të:

a) Informojë të gjitha shtetet të cilat kanë nënshkruar ose kanë aderuar në këtë Konventë për:

i) çdo nënshkrim të ri apo depozitim të instrumentit së bashku me datën përkatëse;

ii) datën e hyrjes në fuqi të kësaj Konvente;

iii) depozitimimin e cilitdo instrument denoncimi të kësaj Konvente, së bashku me datën e depozitimit dhe datën në të cilën denoncimi hyn në fuqi; dhe

iv) deklarata dhe njoftime të tjera të bëra sipas kësaj Konvente.

b) Përcjellë kopje të vërtetuara të kësaj Konvente për të gjitha shtetet nënshkruese dhe shtetet të cilat aderojnë në këtë Konventë.

Neni 18 **Përcjellja tek Kombet e Bashkuara**

Sapo kjo Konventë të hyjë në fuqi, teksti do të përcillet nga Sekretari i Përgjithshëm për tek Sekretariati i Kombeve të Bashkuara për regjistrim dhe botim, në përputhje me nenin 102 të Kartës së Kombeve të Bashkuara.

Neni 19 **Gjuhët**

Kjo Konventë hartohet në një origjinal të vetëm në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, duke qenë secili tekst njëlloj autentik.

Bërë në Londër më njëzet e tre mars, dymijë e një.
Në dëshmi sa më sipër, nënshkruarit, duke qenë të autorizuar në mënyrën e duhur nga qeveritë e tyre përkatëse, nënshkruan për atë qëllim këtë Konventë.¹

SHTOJCË

CERTIFIKATË E SIGURIMIT APO SIGURIE TJETËR FINANCIARE, NË LIDHJE ME PËRGJEGJËSINË CIVILE TË NDOTJES SË SHKAKTUAR NGA KARBURANTI I DEPOZITAVE

Lëshuar në përputhje me dispozitat e nenit 7 të Konventës Ndërkombëtare të vitit 2001 mbi përgjegjësinë civile për dëmet nga ndotja e shkaktuar nga karburanti i depozitave

Emri i anijes	Numrat apo shkronjat dalluese	Numri i identifikimit të anijes i Organizatës Ndërkombëtare Detare IMO	Porti i regjistrimit	Emri dhe adresa e plotë e vendit kryesor të punës së pronarit të regjistruar

Vërtetohet se në lidhje me anijen e sipërpërmendur është në fuqi një policë sigurimi ose një siguri tjetër financiare që përmbush kërkesat e nenit 7 të Konventës Ndërkombëtare të vitit 2001 mbi përgjegjësinë civile për dëmet nga ndotja e shkaktuar nga karburanti i depozitave.

Lloji i sigurimit

Kohëzgjatja e sigurisë

Emri dhe adresa e siguruesit / siguruesve dhe / ose garantuesit / garantuesve

Emri

Adresa

Kjo certifikatë është e vlefshme deri më

Lëshuar ose vërtetuar nga qeveria e

(Përshkrimi i plotë i shtetit)

Ose

Teksti në vijim duhet të përdoret kur një shtet palë shfrytëzon parashikimin e nenit 7 (3)

Kjo certifikatë lëshohet nën autoritetin e qeverisë së ... (përshkrimi i plotë i shtetit) nga ... (emri i institucionit apo organizatës)

Në më
(vendi) (data)

(nënshkrimi dhe titulli i zyrtarit lëshues apo vërtetues)

Shënime shpjeguese:

¹ Nënshkruar për Australinë, në bazë të ratifikimit, në Londër më 23 shtator 2002

1. Nëse dëshirohet, përshkrimi i shtetit mund të përfshijë edhe një referim tek autoriteti kompetent publik i vendit ku është lëshuar certifikata.

2. Nëse shumica e përgjithshme e sigurisë është siguruar nga më shumë se një burim, duhet të tregohet shumica e secilit prej tyre.

3. Nëse siguria është dhënë në disa formularë, këto duhet të renditen.

4. Zëri “Kohëzgjatja e sigurisë” duhet të përcaktojë datën në të cilën hyn në fuqi ky sigurim.

5. Zëri “Adresa” e siguresit / siguresve dhe / ose garantuesit / garantuesve duhet të tregojë vendin kryesor të punës së siguresit / siguresve dhe / ose garantuesit / garantuesve. Nëse është e përshtatshme, duhet të tregohet edhe vendi i punës ku është vendosur sigurimi apo siguria tjetër.

LIGJ

Nr.10 225, datë 4.2.2010

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.10, DATË 23.12.2009 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 10 025, DATË 27.11.2008 “PËR BUXHETIN E VITIT 2009”, TË NDRYSHUAR”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.10, datë 23.12.2009, i Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10 025, datë 27.11.2008 “Për Buxhetin e vitit 2009”, të ndryshuar”.

**Shpallur me dekretin nr.6426, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 226, datë 4.2.2010

PËR NJË SHITESË DHE NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7651, DATË 21.12.1992 “PËR FESTAT ZYRTARE E DITËT PËRKUJTIMORE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 “Për festat zyrtare e ditët përkujtimore”, të ndryshuar, bëhen shtesa dhe ndryshimi si më poshtë:

Neni 1

Në nenin 1 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Pas shkronjës “g” shtohet shkronja “gj” me këtë përmbajtje:
“gj) 8 dhjetori – Dita Kombëtare e Rinisë”.
2. Paragrafi i fundit shfuqizohet.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6427, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 227, datë 4.2.2010

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8366, DATË 2.7.1998 “PËR
SHËRBIMIN GJEOLOGJIK SHQIPTAR (SHGJSH)”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.8366, datë 2.7.1998 “Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH)”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Në nenin 1 fjalët “me përjashtim të Shërbimit Gjeologjik të Naftës dhe Gazit” shfuqizohen.

Neni 2

Në nenin 6 bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

1. Kudo fjala “Studimet” zëvendësohet me fjalët “Vrojtimet, shërbimet, përgjithësimet dhe monitorimet”.
2. Në paragrafin e dytë, fjalët “gjeofizike e gjeokimike të çdo shkalle” zëvendësohen me fjalët “gjeofizike, gjeokimike, përfshirë sizmikën e cekët (inxhinierike), elektrometrinë, magnetimetrinë, gravimetrinë, radiimetrinë, matjet e emisioneve të radonit në tokë, ujë, ajër, si dhe në mjediset e brendshme, të çdo lloji e shkalle”.
3. Në paragrafin e tretë, pas fjalëve “materialeve industriale” shtohet fjala “hidrokarbureve”.
4. Në fund të nenit shtohet një fjali me këtë përmbajtje:
“Promovimi i perspektivës së mineraleve të dobishme.”.

Neni 3

Në nenin 7 fjalia e fundit, pas fjalëve “për naftën dhe gazin” shtohen fjalët “si dhe dokumentacioni faktik i punimeve gjeologjike, hidro-gjeologjike dhe gjeologo-inxhinierike të çdo natyre, të kryera nga subjekte private apo shtetërore të fazës së projektzbatimit”.

Neni 4

Neni 7/1 riformulohet si më poshtë:

“Neni 7/1

Agjencia e Ujit dhe Basenit dërgon në Arkivin Qendror të Gjeologjisë një kopje të projektit, pas miratimit të lejes së shpimit dhe një kopje të relacionit, për rezultatet e punimeve të kryera, pas miratimit të lejes së shfrytëzimit nga Këshilli i Basenit Ujëmbledhës.”.

Neni 5

Neni 8 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 8

Përveç funksioneve të parashikuara në nenet 6, 7 e 7/1, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar kryen shërbime me pagesë për të tretët. Për shërbimet jashtë vendit merret miratimi paraprak i ministrit.”.

Neni 6

Nenet 9, 10, 11 e 12 shfuqizohen.

Neni 7

Neni 14 riformulohet si më poshtë:

“Neni 14

Drejtori dhe zëvendësdrejtori i përgjithshëm emërohen nga ministri.”.

Neni 8

Neni 15 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 15

Drejtori i Përgjithshëm ka këto kompetenca:

- a) drejton dhe është përgjegjës për menaxhimin e veprimtarisë së institucionit;
- b) përfaqëson Shërbimin Gjeologjik Shqiptar në marrëdhëniet me të tretët.”.

Neni 9

Në nenin 16, fjalët “organet drejtuese” shfuqizohen.

Neni 10

Neni 17 riformulohet si më poshtë:

“Neni 17

Struktura, nivelet e pagave dhe të shpërblimit të Shërbimit Gjeologjik Shqiptar miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 11

Neni 18 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 18

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar financohet nga buxheti vjetor, si dhe nga të ardhurat për shërbimet për të tretët.”.

Neni 12

Neni 20 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 20

Ministri përcakton shërbimet me pagesë për të tretët, që kryhen nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar. Tarifat për çdo shërbim për të tretët miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Të ardhurat e krijuara nga tarifat për shërbimet për të tretët përdoren nga Shërbimi Gjeologjik Shqiptar me miratimin paraprak të ministrit, për përmirësimin e punës, nëpërmjet blerjes së pajisjeve, mjeteve teknologjike, aparaturave laboratorike, si dhe për kualifikimin, specializimin e shpërblimin e personelit.”.

Neni 13

Neni 21 riformulohet si më poshtë:

“Neni 21

Dispozitë kalimtare

Me hyrjen në fuqi të këtij ligji, të drejtat dhe detyrimet e sh.a. “Gjeoalba”, sh.a. “Hidrogjeologji” dhe sh.a “Gjeologji-Gjeodezi”, pjesa e dokumentacionit gjeologo-inxhinierik dhe gjeodezik të arkivit qendror teknik, si dhe i gjithë dokumentacioni shkencor i këtyre shoqërive i kalojnë Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

Neni 14

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6428, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 228, datë 4.2.2010

**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR. 8438, DATË 28.12.1998 “PËR
TATIMIN MBI TË ARDHURAT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Neni 1

Në nenin 8 “E ardhura e tatueshme”, pas shkronjës “gj” shtohet shkronja “h” me këtë përmbajtje:

“h) të ardhurat në formë monetare për shtimin e kapitalit me burime nga jashtë shoqërisë, që nuk janë të tatuara më parë, ndërkohë që kanë qenë objekt tatimi dhe që nuk janë të shoqëruara me dokumente zyrtare, që vërtetojnë origjinën e këtyre të ardhurave. Procedurat përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Financave.”.

Neni 2

Në nenin 12/6, në fund të pikës 1 shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me xhiro vjetore të parashikuar nën 2 milionë lekë, duhet të deklarojnë, sipas afateve të përcaktuara në këtë nen, vetëm nëse xhiroja vjetore për vitin ushtrimor kalon vlerën 2 milionë lekë.”.

Neni 3

Në nenin 16 “Fusha e veprimit të tatimit mbi fitimin” bëhen këto ndryshime:

a) Në pikën 1, shkronja “c” ndryshohet si më poshtë:

“c) çdo person tjetër, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur ky është subjekt i tatimit mbi vlerën e shtuar, me përjashtim të rastit kur ky person është subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël;”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë:

“2. Çdo person, sipas kuptimit të këtij ligji, pavarësisht nga statusi ose forma ligjore e regjistrimit apo e njohjes së tij, kur është a bëhet subjekt i tatimit mbi fitimin, ka të drejtë të kërkojë çregjistrimin në çdo kohë, por jo të kalojë si subjekt, që i nënshtrohet tatimit mbi të ardhurat personale mbi biznesin e vogël.”.

Neni 4

Në nenin 22 “Amortizimi”, pika 3 ndryshohet si më poshtë:

“3. Kostot e blerjes ose të ndërtimit, kostot e përmirësimit, të rinovimit e të rikonstruksionit të ndërtesave, të konstruksioneve dhe makinerive e pajisjeve me afat të gjatë shërbimi, amortizohen veçmas, me vlerën e mbetur, me 5 për qind.”.

Neni 5

Neni 33/1 “Destinimi i fitimit” ndryshohet si më poshtë:

“Neni 33/1

Depozitimi i vendimit për miratimin e rezultatit vjetor dhe destinimi i fitimit

1. Shoqëritë tregtare, sipas ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.

2. Shoqëritë tregtare dhe personat fizikë, sipas pikës 1 të këtij neni, duhet të depozitojnë pranë organeve tatimore, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kalendarik, vendimin e organit përgjegjës/vendimin e personit fizik. Për paraqitjen me vonesë të këtij vendimi zbatohet një gjobë prej 10 000 (dhjetë mijë) lekësh për çdo muaj vonesë.

3. Personi juridik duhet të derdhë për llogari të organit tatimor tatimin mbi dividendin e pagueshëm, sipas pikës 1 të këtij neni, jo më vonë se data 31 korrik e vitit kur bëhet miratimi i rezultateve, pavarësisht nëse është bërë ose jo shpërndarja e dividendit.

4. Vendimi i asamblesë së ortakëve, i organit kompetent të shoqërisë/vendimi i personit fizik, sipas këtij neni, për miratimin e rezultatit dhe destinimin e fitimit pas tatimit, duhet të paraqitet në organin tatimor, në përputhje me afatin e përcaktuar në pikën 2 të këtij neni, edhe nëse rezultati për vitin ushtrimor ka qenë me humbje apo zero. Për mosdepozitimin e vendimit zbatohen penalitetet, sipas pikës 2 të këtij neni.”.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6429, datë 16.2.2010 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Gjergj Fishta", mbrapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 24 27 003.

Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2010 është 16 000 lekë.

Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 24.2.2010
Doli nga shtypi më 25.2.2010

Tirazhi: 3000 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 34 lekë